


Lepi
21.5.2015



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 431 , datë 20.5.2015

P Ë R

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.718, DATË 29.10.2004,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE
TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT",
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, datë 10.10.2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit ("Lista e OKB-së"), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës "C", "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", çregjistrohen individët e renditur në shkronjën "a", të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas ndryshimeve në listën e konsoliduar

të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë,
bashkëpunëtorë apo financues për organizatën “Al-Qaida”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I PUNËVE
TË JASHTME

DITMIR BUSHATI

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSMINISTRI

SELIM BELORTAJA

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (“LISTA E OKB-së”)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

a) Lista e ndryshuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”;

1. RIADH; BEN BELKASSEM; BEN MOHAMED; AL-JELASSI,
2. SAMIR; ABD EL LATIF; EL SAYED; KISHK,
3. AL-AZHAR; BEN MOHAMMED; BEN EL-ABED; AL-TLILI,
4. FAOUZI; BEN MOHAMED; BEN AHMED; AL-JENDOUBI,
5. AHMED; HOSNI; RARRBO,
6. NAJIB; BEN MOHAMED; BEN SALEM; AL-WAZ.


Shënim: Gjeneralitetet e tjera për personat emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

NR.PROT.2192/1
DATË 20.5.2015

MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTRISË SË DREJTËSISË
SHISH-IT
BANKËS SË SHQIPËRISË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

A circular official stamp of the Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Albania is partially visible behind the signature. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" and "MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME". The signature is written in black ink over the stamp.